

## Hyrje

Shoqata e Bashkive në vitin 2006 mbush plot 13 vjet nga krijimi i saj në vitin 1993, me iniciativën e 10 Kryetarëve të atëhershëm të bashkive. Që prej asaj kohe Shoqata e Bashkive ka synuar në vazhdimësi të përmbushë misionin e saj, i cili që prej krijimit mbetet në thelb i pandryshuar si më poshtë vijon:

*“SHBSH ka si qëllim të kontribuojë për mbrojtjen e interesave të përbashkëta të njësive të vetqeverisjes vendore të qyteteve, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e strukturave dhe mekanizmave demokratike në organizimin dhe funksionimin e bashkive dhe zbatimin e parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Lokale”.*

Në këtë këndvështrim Shoqata ka përqëndruar aktivitetin e saj në disa drejtime kryesore të cilat kanë marrë mbështetjen e organeve përkatëse të saj dhe në vijimësi kanë ndikuar në fuqizimin e rolit të Shoqatës në vendimmarrjen për çështjen e pushteti vendor.

Sot me krenari mund të themi, që Shoqata është bërë më e pranishme në jetën e përditshme të bashkive në të gjithë vendin. Kryetarët e Bashkive dhe përfaqësues të tjerë të tyre, kanë arritur të bashkëpunojnë në forumet e shoqatës përtej dallimeve politike gjë që e vecon Shoqatën e Bashkive si një organizëm në funksion të decentralizimit dhe në shërbim të kauzave të drejta të autonomisë vendore.

Në vijim po ju paraqesim Draft-Raportin mbi veprimtarinë dhe aktivitetet e zhvilluara nga Shoqata e Bashkive. Draft – Raporti është i ndarë si më poshtë:

- I. Lobimi
  - a) *Bashkëpunimi institucional*
  - b) *Bashkëpunimi ndërkufitar dhe Integrimi Evropian*
  - c) *Dhënia e mendimeve për projekt aktet normative*
- II. Trajnimet dhe Forumet
- III. Shërbimet ndaj anëtarëve
- IV. Projektet
- V. Botimet

### **I. LOBIMI**

Lobimi është një nga veprimtaritë kryesore të SHBSH-së për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të bashkive kundrejt aktorëve dhe faktorëve që luajnë një rol në çështjet e decentralizimit dhe pushtetit vendor. Lobimi si një nga veprimtaritë kryesore të Shoqatës është kryer si në planin formal nëpërmjet takimeve dhe përfaqësimeve zyrtare ashtu dhe në atë informal në takime dhe përfaqësime jo zyrtare.

Shoqata kryesisht ka marrë pjesë në takime pune dhe grupe të hartimit të politikave nga nivelet më të larta deri tek nivelet e specialistëve. Kjo metodologji pune na ka ndihmuar të jemi në korrent të ngjarjeve dhe të luajmë rol dhe ndikim në mbrojtjen dhe përfaqësimin e duhur të interesave të bashkive.

Disa nga proceset më të rëndësishme për pushtetin vendor për vitin 2006, në të cilat Shoqata ka marrë pjesë paraqiten si më poshtë:

### ***Proçesi i legalizimeve***

Shoqata e bashkive i ka kushtuar një vëmendje të veçantë gjatë vitit 2006, proçesit të legalizimit të ndërtimeve të paligjshme, që pati një impakt të madh tek njësitë e qeverisjes vendore.

Për këtë çështje Shoqata e Bashkive ka organizuar gjatë 2006, disa seminare dhe takime me përfaqësues të ALUIZNI-t dhe shumicës së bashkive. Kemi kërkuar me forcë një mbështetje më të madhe financiare për bashkitë në përballimin e procesit të legalizimit, megjithë vështirësitë që janë hasur në alokimin e fondeve të duhura, veçanërisht për bashkitë e mëdha të cilat e kanë më të theksuar problemin e ndërtimeve të paligjshme.

### ***Taksa e biznesit të vogël***

Një nga proceset më të rëndësishme për pushtetin vendor për vitin 2006 ishte edhe finalizimi i ligjit për "Sistemin e taksave vendore", që më së fundi vendosi kalimin e kompetencës së administrimit të taksës së biznesit të vogël tek bashkitë dhe komunat.

Shoqata që prej 3 vjetësh ka mbështetur këtë proces dhe ka kërkuar me forcë kalimin e kësaj kompetence tek bashkitë. Mund të themi, që pas kësaj pune tre vjecare u arrit kjo gjë, edhe falë insistimit të shoqatës tonë. Kjo është një nga arritjet më të dukshme në veprimtarinë lobuese të Shoqatës, e cila përvec takimeve me përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Brëndshme dhe asaj të Financave ka patur takime edhe me përfaqësues të vecantë të parlamentit.

Po në këtë drejtim, Shoqata realizoi edhe një projekt të financuar nga LGDA-USAID për transferimin e kompetencës së administrimit të taksës së biznesit të vogël dhe rekomandimet që dolën nga projekti, ju përcollën bashkive dhe ministrive.

Ajo që duhet kërkuar më tej nga Shoqata, mbetet financimi për bashkitë si efekt i kalimit të kësaj kompetence të re tek to.

Gjithashtu Shoqata ka pasur në vijim një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe mjaft të frytshëm edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për këtë çështje, ku vlen të përmendim që ky bashkëpunim realizohet mbi bazën e *marrëveshjes së bashkëpunimit* të nënshkruar midis dy institucioneve tona, që prej vitit 2002.

Gjithashtu për të përballuar me sukses këtë kompetencë nga ana e bashkive, Shoqata ka organizuar një seri trajnimesh dhe projekte të vecanta për këtë çështje. (për më tepër shih pjesën që flet për trajnimet).

### ***Decentralizimi financiar dhe fiskal***

Financat vendore dhe decentralizimi fiskal e financiar ka qënë një nga fushat prioritare në veprimtarinë e shoqatës, për vetë faktin që akoma financat e pushtetit vendor nuk janë stabilizuar dhe nuk plotësojnë parametrat e standardeve ndërkombëtare. Shoqata e bashkive në

vazhdimësi ka lobuar dhe kërkuar me forcë një decentralizim të mëtejshëm fiskal dhe financiar si në drejtimin kualitativ (cilësor) ashtu edhe në atë sasior. Këtu përmendim pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatës në grupet e punës për çështjen e hartimit të dokumenteve të politikave dhe projektligjeve të "huamarrjes vendore" dhe "financave vendore".

Shoqata e bashkive, ka përforcuar qëndrimin e saj parimor kundrejt institucioneve qeveritare, se çdo lloj kalimi kompetencash tek pushteti vendor, duhet shoqëruar me alokimin e fondeve të mjaftueshme financiare. Kjo politikë e ndjekur nga Shoqata gjen mbështjetjen ligjore në Kushtetutë, Kartën Evropiane të Qeverisjes Vendore dhe ligjin organik të pushtetit vendor.

### ***Procesi i hartimit të ligjit të planifikimit hapësinor (urbanistika)***

Në periudhën 6 mujore qershor-dhjetor 2006, MPPTT-ja me mbështetjen e donatorëve si USAID dhe Banka Botërore, kanë zhvilluar procesin e hartimit të dokumentit të politikave dhe ligjit të ri për "Planifikimin Hapësinor".

Shoqata e Bashkive ka marrë pjesë aktive në të gjitha takimet duke u përfaqësuar me 2 antërë të stafit ekzekutiv si dhe me tre përfaqësues të bashkive më të mëdha të vendit. Ky proces ka zgjatur për 4 muaj, në mënyrë mjaft intensive me 2 takime në javë, ku është arritur që në fund të muajit dhjetor të prezantohen të dy produktet e këtij procesi (dokumenti i politikave dhe projektligji). Pjesëmarrja aktive dhe mendimet e sygjyerimet e Shoqatës janë vlerësuar si nga Ministria ashtu edhe nga donatorët.

#### **a) Bashkëpunimi Institucional**

##### *Marrëdhëniet me institucionet qeveritare*

Nisur nga roli thelbësor që paraqesin institucionet qeveritare në procesin e decentralizimit, për pasojë edhe veprimtaria e lobimit është përqëndruar më shumë në marrëdhëniet me këto institucione. Në 2006 roli i Shoqatës është forcuar më tej dhe ka pasur një përfshirje të gjerë në ato institucione apo borde që kanë një ndikim të madh në pushtetin vendor.

Kryesisht Shoqata ka mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme pune me Ministrinë e Brëndshme, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Ministrinë e Financave si tre nga ministritë me ndikim të madh në pushtetin vendor. Por gjithashtu Shoqata është përfaqësuar edhe në marrëdhëniet me institucionet e tjera të nivelit qeveritar.

Përvec pjesëmarrjes dhe lobimit në proceset e përmendura më sipër, Shoqata ushtron veprimtarinë e saj lobuese dhe përfaqësuese edhe në mënyrë të institucionalizuar në bordet dhe komitetet shtetërore të ndryshme.

Përfshirja e Shoqatës si anëtare në këto borde e komitete, është një tregues cilësor për punën në rritje të shoqatës dhe për besimin që kanë krijuar tashmë aktorët në fushën e decentralizimit për seriozitetin dhe mirëpërfaqësimin e interesave të bashkive.

Në mbështetje të kësaj, më poshtë paraqiten bordet dhe komitetet kryesore ku SHBSH-ja është anëtare dhe ushtron rolin e saj lobues dhe përfaqësues.

## **1. Komiteti Ndërmintoror i Decentralizimit (KND)**

KND-ja është organi më i lartë këshillimor për vendimmarjen në çështjet e decentralizimit dhe pushtetit vendor. Në këtë organ Shoqata e Bashkive përfaqësohet nga Kryetari i Shoqatës. Gjatë vitit 2006 është zhvilluar 1 mbledhje e këtij komiteti ku është vendosur rishikimi i strategjisë dhe plani i veprimit për decentralizimin.

## **2. Grupi i Ekspertëve për Decentralizimin (GED)**

GED-i është organi konsultativ në ndihmë të KND-së ku Shoqata përfaqësohet me 2 anëtarë në cilësinë e Nën/kryetarit të SHBSH-së. Në 2006 ka pasur një riaktivizim të GED-it dhe ky organ po fillon të luajë një rol më aktiv për decentralizimin. Në tremujorin e fundit GED-i ka marrë si detyrë nga KND-ja rishikimin e Strategjisë së Decentralizimit të miratuar në vitin 2000. Shoqata e Bashkive ka dhënë mendimin e saj për versionin e rishikuar të kësaj Strategjie të prezantuar nga Ministria e Brëndshme.

## **3. Këshilli Konsultativ i Biznesit (KKB)**

KKB-ja është organi konsultativ për politikat qeveritare në kuadrin e zhvillimit të ekonomisë dhe biznesit. Ky organ është rikrijuar në vitin 2006 me ligj të posacëm dhe SHBSH-ja është parashikuar të ketë përfaqësuesin e saj në këtë Këshill. Në vitin 2006 SHBSH-ja nuk ka pasur një rol aktiv në këtë Këshill, pasi ky institucion ka filluar punën e tij me riorganizimin pas miratimit të ligjit të posacëm për KKB-në dhe janë zhvilluar për këtë vit vetëm 2 mbledhjet e para.

## **4. Avokatura e Shtetit**

Avokatura e Shtetit është organi që përfaqëson institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, kur këto janë palë në proceset gjyqësore. Shoqata është e përfaqësuar në Këshillin e Avokaturës së Shtetit me një përfaqësues. Në vitin 2006 janë zhvilluar tre mbledhje të këtij Këshilli dhe kryesisht janë diskutuar çështjet e riorganizimit dhe përmirësimit të funksionimit të këtij organi. Shoqata ka insistuar në rritjen e cilësisë së punës së degeve rajonale të Avokaturës së Shtetit me qëllim përmirësimin e konsulencës juridike për bashkitë. Vlerësojmë faktin që kemi gjetur mirëkuptimin e Avokatit të Përgjithshëm dhe bashkëpunimi me këtë institucion do të shtrihet edhe më tej.

## **5. Komiteti Ad-Hoc për Grantet Konkurruese**

Në vitin 2006 është krijuar për herë të parë, pranë Ministrisë së Brëndshme Komiteti për ndarjen e e Granteve Konkurruese. Në këtë komitet Shoqata ka pasur një përfaqësues të saj. Duke qenë viti i parë i funksionimit të këtij Komiteti puna e tij nuk ka qenë në nivelet e kërkuara dhe përfaqësuesi i Shoqatës ka kërkuar përmirësimin e funksionimit të këtij komiteti në vitet në vazhdim me synim rritjen e transparencës dhe kritereve të konkurrueshmërisë së të gjitha bashkive. Theksojmë faktin që Shoqata është bërë një faktor në përmirësimin e skemës së financimit nëpërmjet granteve konkurruese për vitin në vijim 2007.

## **6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

FZSHH-ja është një nga fondet e financimit për pushtetin vendor dhe si i tillë në Bordin Mbikqyrës të këtij Fondi, Shoqata është e përfaqësuar me 2 anëtarë. Për vitin 2006 është mbajtur një qëndrim për rritjen e financimeve të bashkive nga ky burim si dhe është mbështetur strategjia për kthimin e këtij fondi në një Institucion Financiar të tipit bankë për pushtetin vendor.

## **7. Instituti Trajnimit të Administratës Publike (ITAP)**

Shoqata e Bashkive është anëtare e bordit drejtues të ITAP-it dhe ka përfaqësuesit e saj aty. Përfaqësimi i Shoqatës në këtë bord ka konsistuar në nxitjen për të rritur numrin e trajnimeve të ITAP-it për bashkitë si dhe përshtatjen e tyre me realitetin vendor. Megjithatë numri i trajnimeve të ofruara nga ITAP-i për pushtetin vendor në përgjithësi mbetet i limituar dhe për këtë edhe angazhimi i Shoqatës për të përmirësuar këtë gjëndje.

## **8. Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP)**

AITPP-ja në zbatim të ligjit për transferimin e pronave publike, ka krijuar Komitetin për Transferimin e Pronave Publike tek njësitë e pushtetit vendor ku është kërkuar që Shoqata të ketë 1 përfaqësues. Shoqata ka caktuar 1 përfaqësues sic i është kërkuar. Për vitin 2006 ky Komitet nuk është mbledhur asnjë herë, pritet aktivizimi i tij në vitin në vijim 2007.

## **9. Komiteti Shtetëror i Muzeve**

Shoqata e Bashkive përfaqësohet me një anëtar edhe në Komitetin Shtetëror të Muzeve që funksionon pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe që është krijuar në vitin 2006. Duke qenë një institucion i ri, për vitin 2006, Komiteti Shtetëror për Muzetë ka pasur një rol të pakët.

### *Marrëdhëniet me parlamentin*

Marrëdhëniet me parlamentin kanë konsistuar në kontaktet me deputete që përfaqësojnë një qëndrim të vazhdueshëm në përkrahjen e decentralizimit dhe pushtetit vendor si dhe me pjesëmarrjen në mbledhjet e Komisioneve Parlamentare për çështje të tilla si projektligji për legalizimet, për buxhetin e shtetit apo projektligji i policisë së shtetit.

Shoqata e Bashkive e shikon si një detyrim për të rritur rolin e saj përfaqësues kundrejt parlamentit si organi më i lartë vendimmarrës në Shqipëri. Kjo do të mbetet në vijimësi si një prioritet i yni. Për tu përmendur është fakti që në parlament është arritur të konturohet një grup deputetësh nga të gjitha krahët politik, të cilët janë përkrahës së kauzës së decentralizimit.

### *Marrëdhëniet me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare*

Veprimtaria e SHBSH-së në një aspekt të konsiderueshëm varet nga marrëdhëniet me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe që fokus të punës tyre kanë pushtetin vendor. Kryesisht ndihma e donatorëve ka qenë në aspektin financiar, ku janë mbështetur shumica e aktiviteteve të Shoqatës të cilat pa këtë ndihmë nuk do të realizoheshin. Këtu vlen të përmendet si fakt që veprimtaria e Shoqatës edhe për vitin 2006,

në 70% të saj ka qenë e varur nga ndihma e huaj financiare nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe duhet theksuar që në të ardhmen kjo ndihmë do vijë duke u pakësuar dhe do të duhet që vetë anëtarët e Shoqatës, pra bashkitë të mbështesin më tepër veprimtarinë e Shoqatës.

Më poshtë po paraqesim donatorët dhe organizatat ndërkombëtare kryesore që kanë mbështetur dhe mbështesin Shoqatën e Bashkive.

### **1. Ambasada Hollandeze**

Edhe për vitin 2006, Ambasada Hollandeze ishte donatori kryesor i aktivitetit të Shoqatës, nëpërmjet projektit “Fuqizimi i decentralizimit nëpërmjet mbështetjes së bashkive të mesme dhe të vogla dhe Shoqatës së Bashkive”. Mbështetja e Ambasadës ka konsistuar kryesisht në organizimin e Forumeve të Shoqatës, botimet e ndryshme, projektet e binjakëzimit midis bashkive etj. Ky projekt ka mbështetur Shoqatën që prej vitit 2003.

### **2. Fondacioni Hanns Seidel**

Një nga donatorët më të qëndrueshëm dhe që ka mbështetur Shoqatën tonë, ka qenë fondacioni gjerman “Hanns Seidel”. Nëpërmjet këtij fondacioni është bërë e mundur realizimi i një sërë trajnimesh dhe seminaresh në fushën e taksës së biznesit të vogël, policisë bashkiake si dhe në fushën e integritimit evropian dhe atë të bashkëpunimit ndërkufitar.

Gjithashtu ky fondacion ka mbështetur Shoqatën në financimin e disa aktiviteteve rajonale më Shoqatën e Bashkive të Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Bashkëpunimi me këtë fondacion mbetet një nga më të sukseshmit me partnerët ndërkombëtarë dhe që do të mbështesë shoqatën në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e saj. Shoqata ka vlerësuar ndihmën e këtij fondacioni dhe shpreson që ky bashkëpunim të forcohet edhe më tej.

### **3. Këshilli i Evropës**

Këshilli i Evropës ka qënë një nga organizatat ndërkombëtare që i ka qëndruar më afër Shoqatës së Bashkive duke e mbështetur si në planin institucional nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta në Kongresin e Autoriteteve Rajonale dhe Lokale, gjithashtu edhe në aspektin financiar nëpërmjet financimit të projekteve të ndryshme. Projekti i financuar për 2006, në bashkëpunim edhe me OSBE-në ishte projekti i lidershit dhe si produkt i tij, hartimi i “Manualit të Kryetarit të Bashkisë”. Këshilli i Evropës mbetet sot për sot një nga mbështetësit e çështjes së demokracisë lokale në Evropë dhe Shqipëri si dhe të Shoqatës sonë.

Shoqata jonë është gjithashtu anëtare e Kongresit të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale të Këshillit të Evropës i cili është një nga forumet më të rëndësishëm të këtij karakteri në Evropë.

### **4. LGDA-USAID**

Programi i USAID-it për qeverisjen vendore LGDA, ka qënë një nga partnerët më kryesorë në planin e mbështetjes institucionale të decentralizimit në Shqipëri dhe Shoqata ka bashkëpunuar me të në disa nga proceset më kryesore për decentralizimin.

Për sa më sipër, përmendim procesin e hartimit të dokumentit të politikave dhe projektligjeve për:

- huamarrjen vendore
- financat vendore
- planifikimin hapësinor

LGDA-ja mbetet partneri ndërkombëtar me një ekspertizë të cmuar në fushën e decentralizimit dhe si e tillë mbetet në vazhdimësi partner i përbashkët me Shoqatën tonë pasi veprimtaria e ndërsjelltë është komplementare dhe përputhet në shumë pika.

LGDA-ja përvec mbështetjes së decentralizimit në përgjithësi ka shprehur një interesim në rritje për bashkëpunimin me Shoqatën dhe për ta mbështetur atë me projekte konkrete si fillim në 2 fusha. Konkretisht u realizua një projekt i sukseshëm për transferimin e kompetencës së administrimit të taksës së biznesit të vogël tek pushteti vendor, ku u arrit që Shoqata të dalë me rekomandime përkatëse për bashkitë dhe ministritë në kalimin me sukses të procesit të transferimit. Eshte arritur që rekomandimet tona në një pjesë të konsiderueshme të merren parasysh nga Ministria e Financave.

Gjithashtu ka nisur zbatimin e një projekti të përbashkët në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore me synim analizimin e faktorëve që ndikojnë në motivimin dhe qëndrueshmërinë në punë të nëpunësve civilë në pushtetin vendor.

## **5. SOROS-i**

Fondacioni Soros ka mbështetur në vazhdimësi Shoqatën e Bashkive si dhe bashkitë në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Për vitin 2006 Shoqata në bashkëpunim me SOROS-in, realizoi me sukses një projekt për decentralizimin në arsimin parauniversitar.

## **6. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)**

Shoqata për vitin 2006 ka mbajtur marrëdhënie të mira me OSBE-në dhe e ka patur si partner në bashkëfinancimin e disa projekteve ku më i fundit është projekti i liderit në nivelin vendor (bashkëfinancues me Këshillin e Evropës) dhe hartimi i “Manualit të Kryetarit të Bashkisë”.

## **7. Fondacioni “Friedrich Ebert”**

Fondacioni gjerman “Friedrich Ebert” nëpërmjet zyrës së tij në Tiranë ka bashkëpunuar me Shoqatën për vitin 2006 në realizimin e tre seminareve për ngritjen e kapaciteteve të këshillave bashkiak në Tiranë, Shkodër dhe Berat. Kjo është një ndihmë e vlefshme pasi të pakë janë donatorët apo institucionet e tjera që në vëmendjen e tyre kanë këshillat bashkiak.

Shoqata e Bashkive është gjithashtu një aktor aktiv në bashkëpunimin rajonal dhe atë evropian në kuadër të qeverisjes vendore. Më poshtë paraqiten organizatat ndërkombëtare që përfaqësojnë pushtetet vendore në nivelin rajonal dhe evropian.

## **NALAS** (*Rrjeti i Shoqatave Vendore te Evropes Juglindore*)

Shoqata është një nga anëtarët themelues të rrjetit të NALAS-it, që përfshin të gjitha Shoqatat e Autoriteteve lokale të rajonit të Evropës Jug-lindore.

Shoqata ka marrë pjesë rregullisht në takimet e rrjetit duke ndikuar në rritjen e bashkëpunimit me të gjitha Shoqatat homologe të Ballkanit por edhe në zhvillimin e kapaciteteve të personelit të saj.

## **CEMR** (*Këshilli Evropian i Bashkive dhe Komunave*)

Shoqata është anëtarësuar edhe në CEMR, që është një nga organizatat me zë të fuqishëm në politikën evropiane kryesisht në nivelin e BE-së. Ajo ka ndikuar në sensibilizimin për çështjen e qeverisjes vendore në Bruksel, duke ndikuar në rritjen e fondeve të BE-së, për njësitë e qeverisjes vendore.

Në këtë organizatë janë të përfaqësuara nëpërmjet Shoqatave të tyre mbi 100.000 njësi të pushtetit vendor nga e gjithë Evropa. Për të theksuar vlerat që mbart kjo organizatë mund të përmendim faktin se një nga Presidentët e saj ndër vite ka qenë ish-presidenti i Francës dhe ish-President i Komisionit Evropian z.Valery Giscard D'Estaing. Sot ky organizëm udhëhiqet nga Kryetari i Bashkisë së Vjenës.

## **B. Bashkëpunimi ndërkufitar dhe Integrimi Evropian**

Bashkëpunimi ndërkufitar dhe Integrimi Evropian janë dy nga çështjet që kanë qenë në fokus të veprimtarisë së SHBSH-së. Këto dy çështje paraqesin sfidat më të rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë në përgjithësi dhe bashkitë në vecanti.

Bashkëpunimi ndërkufitar është një nga pikat ku përqëndrohet edhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe prej këtej rrjedhin edhe detyrimet përkatëse të bashkive tona. Shoqata ka organizuar në këtë këndvështrim dy seminare për këtë çështje me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Në këtë drejtim është punuar edhe për rritjen e njohurive dhe sensibilizimin e bashkive për procesin e integritit evropian të Shqipërisë, ku Shoqata ka organizuar një trajnim më lektor nga Austria si dhe 1 takim midis Kryetarëve të bashkive dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Integritit.

Për vitet në vijim Shoqata e Bashkive do ti kushtojë një vëmendje kryesore çështjes së integritit evropian, duke u fokusuar në sensibilizimin për përfitimet dhe detyrimet që do të kenë bashkitë nga ky proces sidomos pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA).

## **C. Dhënia e mendimeve për projekt aktet normative**

Lobimi dhe mbrojtja e interesave të bashkive kërkon domosdoshmërisht edhe dhënien e mendimeve të Shoqatës së Bashkive, për projekt aktet normative që ndikojnë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi në pushtetin vendor.



Për vitin 2006, Shoqata ka dhënë mendim për një sërë projektaktesh normative (ligje dhe VKM) me rëndësi për pushtetin vendor, ku përmendim ato më të rëndësishmet si:

- Projektligji “Për legalizimin e zonave informale”,
- Projektligji “Për prokurimin publik”,
- Projektligji “Për sistemin e taksave vendore”,
- Projektligji “Për buxhetin e shtetit”,
- Projektligji “Për policinë e shtetit”,
- Projektligji “Për inspektoriatin ndërtimor”,
- Projektligji “Për planifikimin hapësinor”,
- Strategjia e decentralizimit,
- Strategjia e zhvillimit rajonal,
- Dokumentet e politikave të planifikimit hapësinor,
- Etj,

Përveç sa më sipër edhe një sërë projektligjesh dhe projektvendimesh në fushën e strehimit, financave vendore, mbrojtjes së mjedisit i janë dërguar Shoqatës për mendim dhe është dërguar mendimi i Shoqatës.

Shoqata për çdo projekt-akt normativ që i vjen për mendim nga institucionet përkatëse organizon takime dhe mbledhje për të diskutuar mbi këto projekt-akte kryesisht në forumet e specialistëve si Forumi i Juristëve, Forumi i Financierëve i Urbanistëve apo i Taksave Vendore.

Deri më sot forumet mbeten instrumenti më efikas për të thithur mendimin e specializuar për çështje të ndryshme të decentralizimit. Megjithatë përvoja ka treguar që mendimet e specializuara të Shoqatës jo gjithmonë janë marrë parasysh dhe del në pah nevoja e mbështetjes së këtyre mendimeve nga Kryetarët e Bashkive në nivelet e larta të vendimarrjes politike.

## **II. TRAJNIMET –FORUMET**

Decentralizimi dhe autonomia vendore kërkojnë një nivel të lartë përgatitje nga ana e stafëve të bashkive, në mënyrë që të kryejnë me efikasitet dhe zhdërvjelltësi funksionet dhe kompetencat e besuara atyre, sepse vetë parimi i decentralizimit presupozon kryerjen më të mirë të funksioneve publike nëse zbatohen në nivelin më të afërt të qeverisjes me qytetarët.

Për sa më sipër një nga objektivat afatgjatë të Shoqatës është dhe ngritja e kapaciteteve të stafëve të bashkive. Me modesti mund të themi që ky objektivi është realizuar më së miri nga Shoqata e Bashkive dhe për 2006 Shoqata ka qenë një nga ofruesit kryesorë të trajnimeve dhe seminareve për bashkitë në të gjithë vendin, sidomos për bashkitë e mesme dhe të vogla.

Për ngritjen e kapaciteteve, Shoqata ka përdorur instrumenta të tillë trajnimi si seminare, workshope dhe forume të specialistëve. Vetëm për vitin 2006 janë organizuar mbi **30 sesione trajnimi** (seminare,workshope,forume spoeialistësh) për më tepër se **600 persona** nga të gjitha bashkitë e vendit. Këto shifra imponuese e rendisin Shoqatën e Bashkive ndër organizatat më kryesore për ngritjen e kapaciteteve të bashkive.

Megjithatë duhet të themi që pa financimin e donatorëve këto trajnime nuk do të mund të zhvilloheshin dhe në këtë këndvështrim duke pasur në vëmendje uljen e ndihmave nga donatorët, do të duhet që për të ardhmen ky nivel i kënaqshëm trajnimesh të mbështetet nga fondet e vetë bashkive. Kjo do të sillte me tepër qëndrueshmëri për ngritjen në vazhdimësi të kapaciteteve të stafeve të bashkive pavarësisht faktorëve të jashtëm dhe si rrjedhojë edhe më shumë profesionalizëm në kryerjen e funksioneve publike nga bashkitë.

Tematika e sesioneve të trajnimit ka qenë mjaft e larmishme ku rendisim si më poshtë trajnime të organizuara për:

- taksat dhe tarifave vendore,
- policinë bashkiake,
- prokurimin publik në nivelin vendor,
- këshillat bashkiakë,
- integrimin evropian,
- menaxhimin e burimeve njerëzore,
- sekretaret e Kryetarëve të Bashkive,
- bashkëpunimin ndërkufitar,
- procedurat administrative dhe ligjshmëria në bashki,
- statuti dhe rregullorja e brendshme,
- urbanistikën dhe legalizimet,
- strehimin,
- arsimi parauniversitar,

Vlen të theksojmë që trajnimet e ofruara kanë pasur si lektorë ekspertë shqiptarë me përvojë të madhe në pushtetin vendor si dhe ekspertë të huaj që kanë sjellë në trajnime eksperiencat më të mira ndërkombëtare.

### **III. SHERBIMET NDAJ BASHKIVE**

Shoqata e bashkive përveç veprimtarive dhe aktiviteteve ku përfitues kanë qenë një numër i lartë bashkish, kryen edhe shërbime individuale për bashki të veçanta kryesisht për bashkitë e mesme dhe të vogla.

Këto shërbime mund të karakterizohen si më poshtë:

#### *1. Asistenca juridike*

Një nga shërbimet që Shoqata nëpërmjet drejtorisë së saj juridike ka ofruar për anëtarët e saj është dhënia e konsulencës juridike në fushën e prokurimit publik, taksave dhe tarifave vendore, statusi i nënpunësit civil, policia bashkiake etj.. Kryesisht konsulenca është dhënë nëpërmjet komunikimit verbal me telefon dhe e-mail dhe më pak nëpërmjet korrespondencës së shkruar. Bashkitë që kanë përfituar këto shërbime janë bashkitë e Kuçovës, Përmetit, Këlcyrës, Bilishtit, Korçës, Durrësit, Beratit. Në total janë dhënë mbi **50 këshilla juridike** vetëm për vitin 2006.

Në të ardhmen Shoqata synon të përforcojë sektorin e saj juridik, dhe për rrjedhojë të rrisë edhe më tepër konsulencën e specializuar juridike.

## *2. Mbështetja për organizmin e aktiviteteve të ndryshme*

Shoqata ka mbështetur bashkitë që kanë kërkuar ndihmën e saj në organizimin e aktiviteteve të veçanta të tyre. Kjo ndihmë ka konsistuar në mbulimin e një pjese të vogël të shpenzimeve apo edhe në sigurimin e pjesmarrjes së Kryetarëve të Bashkive të tjera si dhe kontaktet me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare.

Ndër aktivitetet e organizuara që Shoqata ka dhënë ndihmën e saj përmendim si bashkitë më poshtë:

- Bashkia Rubik “Dita e Shën Buhemit”,
- Bashkia Lezhë “Dita e Shtegtarit”,
- Bashkia Berat “Dita e Luleve”,
- Bashkia Kucovë “Inagurim Kopshti”,

## *3. Binjakëzim midis Bashkive*

Shoqata e Bashkive nëpërmjet projektit me Ambasadën Hollandeze, mundësoi binjakëzimin e

- Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Peqin
- Bashkisë Kuçovë dhe Bashkisë Roskovec

E veçanta e këtyre binjakëzimeve kishte të bënte me realizimin e projekteve konkrete ku bashkia e Ebasanit asistoi bashkinë e Peqinit në hartimin e Planit Rregullues të qytetit, ndërsa bashkia Kuçovë asistoi bashkinë e Roskovecit në hartimin e paketës fiskale dhe riorganizimin e zyrë së taksave.

## *4. Hartim i projekteve*

Shoqata e Bashkive ka asistuar bashki të veçanta në hartimin e projekteve apo përmirësimin cilësor të tyre, projekte të cilat janë paraqitur për financim tek donatorët. Bashkitë që kanë përfituar nga ky lloj shërbimi për 2006 kanë qenë bashkitë Korçë, Belsh, Divjakë.

## **IV. PROJEKTET**

Për vitin 2006, Shoqata ka realizuar disa projekte me donatorë të ndryshëm. Më poshtë paraqiten projektet më të rëndësishme.

1. Për 2006 ka vijuar zbatimi i projektit me Ambasadën Hollandeze “Fuqizimi i decentralizimit nëpërmjet mbështetjes të bashkive të vogla dhe të mesme dhe SHBSH-së”.

2. Me LGDA-USAID janë zbatuar dy projekte përkatësisht “Transferimi i kompetencës së administrimit të taksës së biznesit të vogël” si dhe “Qëndrueshmëria dhe lëvizshmëria e nëpunësve civilë në bashki”

3. Me Këshillin e Evropës dhe OSBE-në është realizuar për vitin 2006 projekti për lidhshmërinë dhe është botuar libri “Manuali për Kryetarët e Bashkive”

4. Me qendrën “Paqe nëpërmjet Drejtësisë” është finalizuar në vitin 2006 projekti për trajnimin e trajnerëve për ligjshmërinë në bashki dhe është botuar libri “Guida Administrative”.

Përveç sa më sipër, janë realizuar edhe projekte më të vogla me donatorë të tjerë. Veprimtaria e Shoqatës edhe për këtë vit ka qenë e varur nga realizimi i projekteve të përbashkëta me

financimin e donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare. Në të ardhmen synohet që Shoqata të bëhet më e pavarur nga ndihma e huaj dhe të jetë më e qëndrueshme në veprimtarinë e saj duke u mbështetur më tepër në burimet e anëtarëve të saj.

## V. BOTIMET

Një nga veprimtaritë ku është përqëndruar Shoqata ka qenë dhe publikimi i botimeve të ndryshme për bashkitë dhe pushtetin vendor në përgjithësi. Me poshtë paraqiten disa nga botimet e Shoqatës për vitin 2006, të cilat janë financuar nga partnerë të brëndshëm dhe të jashtëm.

- **“Manual për Kryetarët e Bashkive”** botuar me ndihmën e Këshillit të Evropës dhe OSBE-së,
- **“Model i Statutit dhe Rregullores së Brendshme të Bashkive”**, botuar me ndihmën e Ambasadës Hollandeze,
- **“Guida Administrative”**, botuar në partneritet me Qendrën “Paqe nëpërmjet Drejtësisë”,